

VENDIM
Nr. 41, datë 5.10.2022

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË
BANKËS SË SHQIPËRISË NR. 49, DATË 5.8.2020, “PËR MIRATIMIN E
MBYLLJES SË FAZUAR TË AKTIVITETIT TË NDËRMJETËSIMIT TË
INVESTIMIT TË PERSONAVE FIZIKË NË BONO THESARI NËPËRMJET
BANKËS SË SHQIPËRISË”, DHE PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE
NË VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË
NR. 33, DATË 6.7.2022, “PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË
RREGULLOREN, ‘PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR TË
REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 113, pikat 1 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44, datë 30.4.2015, me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 49, datë 5.8.2020, “Për miratimin e mbylljes së fazuar të aktivitetit të ndërmjetësimit të investimit të personave fizikë në bono thesari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë”.

2. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 33, datë 6.7.2022, “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren ‘Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)””, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, nënpika ii, “e”, nënpika “i”, “g” dhe “k” shfuqizohen;

b) Pika 2 shfuqizohet.

3. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko